

STATUTI
ISHOQËRLSË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR "The Clinic" Sh.p.k.

Bazuar ne Aktin e Themelimit dhe ne zbatim te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", veprimtaria e shoqerise "The Clinic" sh.p.k. do te organizohet e drejtohet ne baze te normave te ketij statuti.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Parimet dhe normat e ketij statuti shprehin vullnetin e Ortakeve dhe kerkesat e Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" Ato rregullojne aktivitetin, strukturen e shoqerise dhe jane taksative.

Neni 2

Per probleme dhe çeshtje qe nuk gjejne zgjidhje ne kete statut, zbatohen kerkesat e Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Ligjit Nr. 9723 dt 30.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" dhe dispozitat e Kodit Civil.

PERSONALITETI DHE SELIA

Neni 3

Shoqeria "The Clinic" sh.p.k eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me kapital teresisht vendas. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe ushtron aktivitetin e saj ne te gjithe territorin. Veprimtaria e saj i nenshtrohet ligjit shqiptar.

Neni 4



Selia e Shoqerise do te jete ne Tirane, ne adresen : Tirane Rruga e Kavajes, Tirana Garden Building, kati 4. Biznesi dhe adresa mund te ndryshojne me vendim te Asamblese se Ortakeve. Çdo ndryshim i Selise kerkon regjistrimin ne QKR. Shoqeria mund te krijojte seli te tjera dhe filiale te saj si ne Shqiperi ashtu dhe jashte territorit shqiptar, ne perputhje me ligjin.

Neni 5

Shoqeria "The Clinic" sh.p.k vepron me ane te strukturave te saj. Veprimet e kryera prej tyre shprehin vullnetin e shoqerise dhe e kushtezojne ate te mbaje pergjegjesi ndaj te treteve.

Neni 6

Shoqeria "The Clinic" sh.p.k do te ushtroje veprimtarine e saj per nje afat kohor te pacaktuar. Ajo merr persiper te drejta dhe detyrime nga momenti i themelimit dhe regjistrimit te saj ne organet kompetente.



OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 7

Shoqeria "The Clinic" sh.p.k ka per objekt:

Shërbime në fushën e estetikës. Konsulta per semundjet infektive-venerologjike. Ofrimin e shërbimeve te trajtimit te kujdesit personal perfshire por pa u kufizuar ne trajtime bukurie. Si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike, që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë e që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Per te gjithë aktivitetet per ushtrimin e te cilave kerkohet license e posacme , shoqeria do te ushtroje aktivitetin pasi me pare te jete pajisur me licensen perkatese nga organet kopetente.

KAPITALI I RREGJISTRUAR DHE KUOTAT

Neni 8

Kapitali i Regjistruar i shoqerise "The Clinic" sh.p.k eshte 10,000 leke. Kapitali i Regjistruar do te perbehet nga 2 kuota, ku vlefte nominale e ketyre kuotave eshte 5.000 leke secila.

Kapitali i Regjistruar zoterohet nga 2 ortake, Znj.Migena Qato, e cila zoteron 50% te kapitalit dhe Znj. Esta Kokla, e cila zoteron 50% tjeter te kapitalit.

Neni 9

Kapitali i Rregjistruar dhe numri i ortakeve mund te rritet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, qe perfaqeson jo me pak se 3/4 e kuotave te Kapitalit te Regjistruar.

Ne rast Zmadhimi te Kapitalit te Regjistruar çdo ortak mund te abstenoje ne nenshkrimin e kapitalit te ri duke ruajtur kuoten e meparshme te tij, ose te terhiqet nga shoqeria brenda 30 ditesh nga vendimi i marre per zmadhimin e kapitalit.

Kuotat emerore te Kapitalit te Regjistruar jane te transferueshme me dokument noterial midis te gjalleve ose trashegimtareve te tyre sipas ligjit per trashegimine dhe kerkesave te nenit 73 te Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 10

Ortaku qe deshiron t'i tjetersoje nje te treti kuotat e tij ose nje pjese te tyre, duhet te depozitoje kerkesen e tjetersimit nepermjet nje letre rekomande duke i bere te njohur shoqerise dhe ortakeve te tjerg çmimin dhe menyren e tjetersimit. Ortaket ekzistues kane te drejten e parablerjes.

Neni 11

Ne rast se njeri nga ortaket heq dore qofte edhe pjeserisht nga bleja e kuotave te ofruara,

kuotat e refuzuara shtohen ne favor te ortakeve te tjere ne raport me pjesemarrjen e tyre ne Kapitalin e Regjistruar. Kuoten e ofruar per blerje, ortaket detyrohen ta blejne teresisht.

Neni 12

Nese asnjeri nga ortaket nuk ushtron te drejten e parablerjes dhe nese shoqeria nuk komunikon vendimin e saj brenda 30 ditesh nga depozitimi i kerkeses, tjetersuesi ka te drejte t'i ofroje kuoten e vet nje te treti por jo me çmim me te vogel nga ai i ofruar i shoqerise.

Shoqeria duhet te jape pelqimin e saj per pranimin e ortakut te ri brenda afateve logjore, ne te kundert miratimi konsiderohet i dhene.

Çdo kalim i kuotave ne kundershtim me keto norma nuk mund te rregjistrohet ne librin e ortakeve te shoqerise dhe as ne QKB.

MARREDHENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKEVE

Neni 13

Ortaket kane te drejte te ndajne ne formen e dividendit pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise ne raport me kuotat e zoteruara ne Kapitalin e Regjistruar te saj.

Neni 14

Shoqeria mund t'u shpemdaje fitim ortakeve vetem nese pas pagimit te dividendit ekzistojne keto kushte :

a.- Aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj.

b.- Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme nga te tretet brenda 12 muajve ne vazhdim .



Per plotesimin e ketyre kushteve Administratori, ne pergjegjesine e tij personale, leshon nje Certificate te aftesise paguese.

ASAMBLEJA

Neni 15

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese, ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Asambleja e Ortakeve konsiderohet prezent me pjesemarrjen e 51% te zoteruesve te Kapitalit te Regjistruar.



Çdo ortak ka te drejten e nje vote, per cdo kuote qe zoteron ne Kapitalin e Rregjistruar. Ortaku i Vetem merr vendime ne emer te Asamblese se Ortakeve.

Neni 16

Ne asamble marrin pjese ortaket qe rezultojne te regjistruar ne librin e shoqerise.

Çdo ortak mund te perfaqesohet nga nje person tjeter ne asamble me autorizim me shkrim. Perfaqesuesi i tij mund te jete ortak apo nje person i trete, por jo administrator i shoqerise. Autorizimi jepet vetem per nje mbledhje te asamblese si dhe ne mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Asambleja e Zakonshme duhet te thirret te pakten njehere ne vit, brenda gjashte muajve nga mbyllja e aktivitetit financiar te shoqerise.

Asambleja e Jashtezakonshme thirret per vendime urgjente ne cdo rast qe administratori e ndjen te nevojshme ose me kerkesen e çdo ortaku qe perfaqeson 10% te Kapitalit te Rregjistruar.

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave . Ndersa kur vendimet kerkojne shumice te kualifikuar ortaket pjesemarres ne asamble duhet te zoterojne me shume se gjysmen e totalit te kuotave.

Ne mungese te formaliteteve te mesiperme, asambleja konsiderohet rregullisht prezent me pjesemarrjen e 100% te pjeseve te Kapitalit te Rregjistruar. Secili nga pjesemarresit mund te kundershtojte diskutimin e çeshtjeve mbi te cilat mendon se nuk eshte informuar plotesisht apo kur çeshtja bie ndesh me nenet e statutit dhe te Ligjit per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

Neni 17

Asambleja kryesohet nga Administratori i cili zgjidhet midis ortakeve deri ne doreheqjen ose ne shkarkimin e tij. Ne mungese te tij ajo drejtohet nga ortaku me i madh ne moshe ose nga nje person i caktuar nga shumica e ortakeve te pranishem.

Per mbajtjen e proçesverbalit, Administratori emerion nje sekretar, me perjashtim te rasteve kur proçesverbali mbahet nga nje noter.

Neni 18

Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thiriur sipas pikes 1 te nenit 83 te ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem ne se te gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullisë.

Neni 19

Te gjitha vendimet e asamblese do te verbalizohen ne librin perkates dhe procesverbali duhet te firmoset nga administratori ose nga sekretari i emeruar nga ai, me perjashtim te rasteve qe sipas ligjit duhet te mbahet nga nje rioter.

Kundershtimet e mundshme te vendimeve duhet te paraqiten ne baze te Ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare dhe Rregjistrin Tregtar.

ADMINISTRIMI

Neni 20

Shoqeria administrohet nga administratore Znj. Esta Kokla, emeruar me date 01/09/2025, me nje afat 5 vjet, me te drejte perseritje.

Administratori ka fuqi te pakufizuara per veprime administrative ne shoqeri dhe ne marredhenie me te tretet, me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe statuti ja njeh asamblese.

Neni 21

Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit jane sipas nenit 95 te Ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 22

Administratori eshte perfaqesues ligjor i shoqerise. Per çdo ndryshim te tagrave perfaqesuese te tij, njoftohet QKB per regjistrim.

Neni 23

Administratori kryen detyrimin e besnikerise dhe mban pergjegjesi per çdo veprim apo mosveprim sipas pikave 2.3 dhe 4 te nenit 98 te Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 24

Shperblimi i Administratorit caktohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare , Asambleja mund te vendose reduktimin e shperblimit te administratorit dhe kjo publikohet se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Neni 25

Firma per pagesat ne emer te shoqerise i takon Adnistratorit.

RAPORTET E PUNES



Neni 26

Administratori gezon te drejten e punesimit te personave te tjere ne shoqeri dhe te nenshkruaje kontraten e punes.

Neni 27

Raportet e shoqerise me te punesuarit rregullohen me ane te Kontrates se Punes e cila duhet te permbaje rigorozisht te drejtat dhe detyrat qe Kodi i Punes iu njeh paleve.

Te punesuarit ne Shoqeri pergjigjen sipas ligjit dhe sipas Statutit per moszbatimin e detyrave te caktuara, si dhe per demet qe ata i shkaktojne Shoqerise. Ata mbajne pergjegjesi



administrative apo penale per demet e shkaktuara nga moszbatimi i detyrave te tyre.

KONTROLLI I BRENDSDHEM

Neni 28

Shoqeria organizon kontrollin e brendshem te aktivitetit te saj me Eksperte Kontabel te Regjistruar.

Asambleja e ortakeve, mund te emeroje nje ose me shume eksperte kontabel. Funksioni dhe kohezgjatja ne detyre rregullohet nga dokumenti i emerimit dhe kontrata ndermjet paleve.

BILANCI DHE FITIMI NETO I SHOQERISE

Neni 29

Aktiviteti financiar i shoqerise fillon me krijimin e saj dhe mbyllet ne 31 Dhjetor te çdo viti. Ne fund te çdo viti Administratori merr masa per hartimin e bilancit te aktivitetit sipas afateve dhe menyrove te parashikuara nga ligji "Per kontabilitetin" dhe SKK ne fuqi. Ai harton nje relacion mbi mbarevajtjen e shoqerise gjate vitit.

Neni 30

Bilanci i shoqerise dhe dokumentacioni i nevojshem duhet te miratohen nga Asambleja e Zakonshme e Ortakeve brenda gjashte muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

Neni 31

Fitimi neto i shoqerise do te ndahet ne raport me kuotat e zoteruara ne Kapitalin e Regjistruar.

Fitimi neto qe rezulton nga bilanci vjetor do te ndahet:

- a) 5% shkon ne fondin e Rezerves se Domosdoshme , perderisa te plotesohet 1/10 e Kapitalit te Regjistruar.
- b) Pjesa tjeter vihet ne dispozicion te asamblese per t'ju ndare ortakeve ne proporcion me kuotat qe zoterojne ne Kapitalin e Rregjistruar, apo ne destinacione te tjera si zmadhim kapitali, ose krijim rezervash te ndryshme etj.

SHKRIRJA E SHOQERISE DHE LIKUIDIMI

Neni 32

Aktiviteti i shoqerise mund te mbyllet perpara afatit te parashikuar ne aktet themeluese kur bilanci i saj rezulton jo fitimprures dhe ne çdo rast tjeter me vendim te asamblese se ortakeve ose me kerkesen e ortakeve qe perfaqesojne 10% te Kapitalit te Rregjistruar.

Neni 33

Ne rast falimentimi te shoqerise asambleja e ortakeve percakton menyren e likuidimit dhe emeron nje ose me shume likuidues duke percaktuar dhe pagesen e secilit.

Neni 34

Per çdo rast konflikti te shoqerise me te tretet dhe ndermjet ortakeve dhe ne rast mosarritje te konsensusit, çdonjeri gezon te drejten e prezantimit te çeshtjes organeve kompetente gjyqesore dhe arbitrazhit nderkombetar.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 35

Te gjitha vendimet, kundershimet dhe sugjerimet e organeve drejtuese te ortakeve te shoqerise, do te evidencohen ne nje liber protokolli, i cili do te kete vlere ruajtje sipas ligjit mbi arkivat.

Neni 36

Ndalohet konkurrenca midis ortakeve per te njejten veprimtari.


Neni 37

Shoqeria ka vulen e saj, stema e se ciles permban shkrimet e nevojshme qe tregojne emrin e shoqerise.


Neni 38

Ky statut u hartua ne kater kopje origjinale, miratohet dhe firmoset rregullisht nga Ortaket e shoqerise:

Z. Migena Qato



Znj.Esta Kokla.



Tirane, 01/09/2025